



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 147

Tiranë – E Enjte, 25 Shtator 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i KM nr. 606, datë 17.9.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 903, datë 26.8.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI)”, të ndryshuar..... 6737
Vendim i KM nr. 608, datë 17.9.2014	Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre..... 6737
Vendim i KM nr. 609, datë 17.9.2014	Për emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në..... 6739
Vendim i KM nr. 610, datë 17.9.2014	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2014 për shpenzime korrente, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë..... 6739
Vendim i KZHR nr. 14, datë 23.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve” dhe shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... 6740

**VENDIM**

Nr. 606, datë 17.9.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 903, DATË 26.8.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN E AGJENCISË SË KËRKIMIT,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
(AKTI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 903, datë 26.8.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 7, bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të paragrafit shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ministri përgjegjës për inovacionin është nënkryetar i bordit drejtues të AKTI-t.”.

b) Në pikën 7.1, fjalët: “Zëvendësministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit”, shfuqizohen.

c) Në pikën 7.4, pas “Kryetari”, shtohet “nënkryetari”.

2. Në pikën 8.1 fjalët “... të ketë gradën shkencore doktor...”, shfuqizohen.

3. Pikat 8.2 dhe 8.3, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama**VENDIM**

Nr. 608, datë 17.9.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË
NEVOJSHME PËR GRUMBULLIMIN
DHE TRAJTIMIN E MBETJEVE BIO SI
DHE KRITERET DHE AFATET PËR
PAKËSIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 28, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011,

“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në këtë vendim përcaktohen:

a) rregullat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime trajtimi;

b) trajtimi i mbetjeve bio, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit;

c) hapat dhe afatet për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio;

ç) procedurat që ndjekin njësitë e qeverisjes vendore për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio.

2. Objekt i këtij vendimi janë mbetjet nga shtëpitë, restorantet dhe parqet, të cilat ndodhen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, nenin 5, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

4. Afati për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve bio, nga njësitë e qeverisjes vendore, është:

a) për bashkitë qendër qarku, brenda vitit 2017;

b) për bashkitë e tjera, brenda vitit 2018.

5. Njësitë e qeverisjes vendore, në planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve dhe në përputhje me nevojat vendore, realizojnë grumbullimin e mbetjeve bio me frekuenca ditore, javore (ose më të gjata se javore), ose zbatojnë sisteme të tjera të ndryshme për grumbullimin e mbetjeve bio, të tilla si kompostimi i mbetjeve në oborret e shtëpive. Vendi ku do të vendosen koshat e mbetjeve bio përcaktohet nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore.

6. Sistemet e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bio përfshijnë:

a) koshat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim;

b) mjetet e posaçme të transportit për grumbullimin e tyre;

c) pajisjet për copëtimin e mbetjeve bio;



ç) vendet për ruajtjen e përkohshme të tyre;

d) stacionet e transferimit.

7. Koshat, për grumbullimin e mbetjeve bio, duhet të jenë:

a) me ngjyrë kafe;

b) rezistentë ndaj lagështirës;

c) rezistentë ndaj plasaritjeve dhe thyerjeve, gjatë përdorimit të përditshëm;

ç) të mbuluar me kapakë hermetikë;

d) të përshtatshëm për t'u pastruar lehtësisht;

dh) të etiketuar për llojin e mbetjeve që përmbajnë.

8. Trajtimi i mbetjeve bio bëhet nëpërmjet trajtimit aerobik, në prani të oksigjenit, ose anaerobik, në mungesë të oksigjenit.

9. Objektivat që duhen arritur nga njësitë e qeverisjes vendore, për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në landfill, janë:

a) ulja, në masën 50% të peshës totale të mbetjeve bio, të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

b) ulja, në masën 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuar në vitin 2014, jo më vonë se 12 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Përdorimi i materialeve të prodhuara nga trajtimi i mbetjeve bio për përmirësimin e cilësisë së tokës llogaritet si pjesë e objektivave të arritur për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve bio.

11. Masat, kriteret dhe rregullat që duhen zbatuar për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve bio përcaktohen në planin vendor të menaxhimit të mbetjeve, të përgatitur në përputhje me Planin Rajonal dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

12. Masat e përcaktuara në këtë vendim, për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, përfshijnë:

a) analizën dhe vlerësimin e situatës fillestare dhe/ose përmirësimin e skemës ekzistuese, ose planit vendor/rajonal të menaxhimit të mbetjeve;

b) vlerësimin e volumit dhe përcaktimin e origjinës së mbetjeve që do të menaxhohen. Informacioni përfshin të dhënat aktuale dhe trendet e mëparshme, për një periudhë 5-8 vjeçare, në lidhje me numrin e banorëve, numrin e shtëpive, llojin dhe madhësinë e fermave, numrin e kopshteve, parqeve publike dhe ndërtesat sociale ose kulturore, brenda territorit

që kanë në juridiksion njësitë e qeverisjes vendore, të cilat mund të prodhojnë mbetje bio;

c) informacion shtesë për shtëpitë në qytet dhe fshat, duke specifikuar llojin e rezidencës (të përhershme ose të përkohshme).

13. Në rastet e zonave me shtëpi private, njësia e qeverisjes vendore duhet të sigurojë kontenierë individualë, për të lehtësuar trajtimin e duhur të mbetjeve bio.

14. Njësia e qeverisjes vendore në zonat rurale përcakton, për banorët brenda territorit që ka nën juridiksion, mënyrat, vendet dhe afatet kohore për trajtimin e mbetjeve bio në shtëpi ose në nivel lagjeje.

15. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë midis tyre për të nxitur:

a) sisteme të përbashkëta të grumbullimit të mbetjeve bio;

b) ngritjen e skemës së ndarjes së mbetjeve bio.

Ky bashkëpunim mundëson grumbullimin optimal të mbetjeve bio, ripërdorimin dhe riciklimin, ose asgjësimin, në një nga impiantet më të afërt, me teknologjitë dhe metodat më të përshtatshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik.

16. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon bazën e të dhënave për:

a) regjistrimin e peshës së mbetjeve bio të grumbulluar;

b) mjetet dhe mënyrat e grumbullimit;

c) frekuencën e grumbullimit;

ç) sasinë e dërguar për trajtim;

d) identifikimin e kontraktorëve të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve bio;

dh) destinacionin e mbetjeve bio;

e) sasinë e mbetjeve bio të trajtuar/përpunuar, në raport me sasinë e grumbulluar, sipas formulës:

$$\frac{\sum \text{SPMBT}}{\sum \text{SPMBG}} \cdot 100 = \text{PMBT}$$

$\sum \text{SPMBT}$ – Shuma e sasisë së përgjithshme të mbetjeve bio të trajtuara në një vit.

$\sum \text{SPMBG}$ – Shuma e sasisë së përgjithshme të mbetjeve bio të grumbulluara në një vit.

PMBT –Përqindja e mbetjeve bio të trajtuara.



17. Çdo njësi e qeverisjes vendore raporton, brenda fundit të muajit dhjetor të çdo viti, në këshillin e qarkut përkatës, të dhëna mbi grumbullimin e mbetjeve bio dhe objektivat e trajtimit, si pjesë e raportimit për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

18. Çdo qark i raporton, brenda fundit të muajit shkurt të çdo viti, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të dhënat e grumbulluara nga njësitë e qeverisjes vendore, siç përcaktohet në pikën 17, të këtij vendimi.

19. AKM-ja përpunon të dhënat mbi peshën totale të mbetjeve bio, të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, dhe objektivat e arritur në nivel kombëtar dhe i regjistron ato në regjistrin e krijuar për këtë qëllim, sipas kërkesave të mëposhtme:

a) Përshkrimi i metodave të grumbullimit të mbetjeve bio;

b) Përshkrimi i metodave të regjistrimit të sasisë së mbetjeve bio;

c) Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga njësitë e qeverisjes vendore;

ç) Vlerësimi i përgjithshëm mbi objektivat e arritura për mbetjet bio.

Këto të dhëna dërgohen në Ministrinë e Mjedisit brenda fundit të muajit mars të çdo viti.

20. AKM-ja i përfshin rezultatet e raportit për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio në raportin vjetor për gjendjen e mjedisit.

21. Ministria harton raportin mbi zbatimin e këtij vendimi, si pjesë integrale të raportit për zbatimin e ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të parashikuar në nenin 66 të tij, i cili publikohet në faqen elektronike zyrtare të saj dhe bëhet i disponueshëm për publikun.

22. AKM-ja krijon, menaxhon dhe përditëson sistemin e bazës së të dhënave për grumbullimin e mbetjeve bio.

23. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 609, datë 17.9.2014

PËR EMËRIMIN E TRE ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TND-NË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në të:

- z. Aleksandër Xhuvani;
- znj. Ledia Plaku;
- znj. Besa Shahini.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të kreut XI, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, mandati i këtyre anëtarëve fillon në mbledhjen e parë konstituive të KKP-së dhe kohëzgjatja e tij përcaktohet në bazë të shortit që do të organizohet për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 610, datë 17.9.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014 PËR SHPENZIME KORRENTE, NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, datë 30.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2014 për shpenzime korrente, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si më poshtë vijon:

a) Programit të Përkujdesit Social, për vitin 2014, tit. 10430, kap. 1, art. 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i shtohet fondi prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

b) Programit për punësim, formim dhe arsim profesional 2014, tit.10550, kap. 1, art. 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i pakësohet fondi prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 14, datë 23.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 13, DATË 6.8.2014, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, PJESE E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE” DHE SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, PJESE E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në listën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshime sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpërndarjen e disa fondeve, si pjesë e financimit të papërdorur, të detajuara në

vendimin nr. 12, datë 1.8.2014, “Për detajimin e përdorimit dhe ndarjes së fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve”, si më poshtë vijon:

a) Fondi prej 94 000 000 (nëntëdhjetë e katër milionë) lekësh, i detajuar në pikën 4, të vendimit nr. 12, datë 1.8.2014, të shpërndahet sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Fondi prej 33 595 576 (tridhjetë e tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, detajuar në pikën 5, të vendimit nr. 12, datë 1.8.2014, të shpërndahet sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Fondi prej 34 410 218 (tridhjetë e katër milionë e katërqind e dhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, i miratuar me vendimin nr. 5, datë 16.4.2013, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për financimin e projekteve të reja për infrastrukturën rrugore dhe arsimin parauniversitar”, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për financimin e projekteve me numër rendor 30, 33, të listës nr. 1, bashkëlidhur vendimit, për arsye të mosprokurimit të projekteve, vihet në dispozicion për rishpërndarje dhe financim të projekteve të tjera.

4. Fondi prej 473 267 281 (katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekësh, me burim financimi:

a) fondet për rishpërndarje, sipas pikës 4, të këtij vendimi, dhe

b) pjesën e financimit të papërdorur për projekte të miratuara, për financim gjatë vitit 2014, si diferencë midis vlerës së miratuar dhe vlerës së kontraktuar (në përfundim të procedurave të prokurimit publik dhe kontraktimit të kryerjes së punimeve), vihet në dispozicion për infrastrukturën vendore.

5. Fondi i përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, do të shpërndahet për:

a) projektet sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) financimin e projekteve të reja të infrastrukturës vendore, sipas pikës 6, të këtij vendimi.

6. Shpalljen e thirrjes së katërt për projektet e infrastrukturës vendore, me ndikim për zhvillimin ekonomik të rajoneve, rehabilitimin mjedisor e gjelbërimit, studime e projekte, si



dhe projekte të vogla vendore, me financim sipas pikës 5, të këtij vendimi. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit të projekteve përcaktohen në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e infrastrukturës vendore, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2014.

8. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore, thirrja e tretë
Projekti nr. 8, i listës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
		QARKU TIRANË			
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rivitalizim urban i dy shesheve në Tiranë (1. Rehabilitimi i hapësirave urbane pranë Teatrit të Kukullave dhe lidhja me rrugën “Ibrahim Rrugova”; 2. Rehabilitimi dhe sistemimi urban në hapësirën midis Ministrisë së Punëve të Brendshme, MZHUT-së, MTI-së, Teatrit Kombëtar dhe Teatrit të Komedisë)	153,120,485	36,260,000	116,860,485
TOTALI			153,120,485	36,260,000	116,860,485

Shënim.

1. a “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues).

1.b “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.

1.c Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.



Tabela 2. Projektet e reja për financim të infrastrukturës vendore

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
QARKU LEZHË					
1	Bashkia Rrëshen	Rikonstruksion i rrugës "Ura e pazarit- Varrezat Publike", Unaza e madhe	82,714,200	13,102,554	69,611,646
2	Bashkia Lezhë	Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës së qytetit	31,945,895	6,389,179	25,556,716
QARKU BERAT					
3	Bashkia Berat	Rehabilitimi i Fasadave përgjatë Bulevardit kryesor	44,086,936	7,097,244	36,989,692
QARKU GJIROKASTËR					
4	Bashkia Memaliaj	Rikonstruksion i rrugës "Rrapo Cela", rrugës hyrëse të qytetit dhe rrugës "Rrashid Brahimi"	39,238,712	7,590,324	31,648,388
QARKU VLORË					
5	Bashkia Himarë	Rikonstruksion, sistemim i fasadave dhe ndërhyrje rehabilituese të fshatit Kudhës	12,000,000	2,400,000	9,600,000
QARKU TIRANË					
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Porcelan - Kinostudio - Surrel	417,207,528	57,420,699	359,786,829
QARKU DURRËS					
7	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës së Gjirit të Lalzit (asfaltimi i rrugës Maminas, Shën Pjetër - Bregdet)	16,570,365	3,314,073	13,256,292
Totali			1,063,208,021	94,000,000	533,193,271

Shënim.

1.a "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues);

1.b "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014;

1.c Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.

2. Objektet me autoritet kontraktues Bashkinë Lezhë (projekti 2), si edhe Bashkinë Berat (projekti 3), do të zbatohen në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore".



Tabela 3. Projektet e gjelbërimit dhe rehabilitimit mjedisor

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
QARKU VLOREË					
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Gjelbërimi i vijës bregdetare të qytetit të Vlorës, Lungomare	104,000,000	20,800,000	83,200,000
QARKU TIRANË					
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Gjelbërimi i parkut të liqenit të Tiranës	63,977,880	12,795,576	51,182,304
TOTALI			167,977,880	33,595,576	134,382,304

Shënim.

1.a “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues);

1.b “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014;

1.c “Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.”

Tabela 4. Projektet për financim të infrastrukturës vendore

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Projekti “Krijimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit dhe menaxhimit rajonal, faza e parë”	420,000,000	42,000,000	378,000,000
TOTALI			420,000,000	42,000,000	378,000,000

Shënim.

1.a “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues);

1.b “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014;

1.c Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.

2. Objekti me autoritet kontraktues FSHZH-në (Projekti i krijimit të sistemit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit dhe menaxhimit rajonal, faza e parë) do të zbatohet në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në përputhje me ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.



Shtojcë I

A. KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projektaplikime për projekte të infrastrukturës vendore
Për një periudhë 2-ditore, pas botimit në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 2, të këtij vendimi.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al . 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Zhvillimit Urban) 3. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
2 ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban, Fondi Shqiptar i Zhvillimit)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas shkronjës A, të shtojcës
	Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban, Fondi Shqiptar i Zhvillimit)	Paraqitja zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm e listës së projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar
3 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me planet vendore, ndërvendore dhe rajonale, i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, të shtojcës
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatitja e materialeve për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve
2 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati i përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrja në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të arsimit, si pjesë e FZHR-së

Shënim. Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për objektet e arsimit, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara këtë shtojcë, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë shtojcë.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në këtë shtojcë, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë shtojcë.



B. FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunat)
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (infrastruktura vendore)
Nësektori i projektit (*)	Të përcaktohet nësektori i projektit
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur, se: - ku konsiston projekti/studimi; - cilat janë problemet që adreson; - cila është vendndodhja e projektit/vendndodhja e studimit; - risqet për zbatimin e tij, ndikimi etj, - sipas kriterëve mbi bazën e të cilave do të vlerësohet projekti.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se një projekti, renditini projektet sipas prioritetit/ nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi, në rast bashkëfinancimi nga njësi e qeverisjes vendore	
Financim nga donatorë, nëse ka	
Financime të tjera, nëse ka	
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe përfundojë procedura e prokurimit publik, si dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga njësi e qeverisjes vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti: - ka vendim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore për miratimin e projektit; - ka vendim të këshillit të njësisë vendore; (komunës/qarkut/bashkisë), për miratimin e sheshit të ndërtimit, dhe ndërtimit të projektit; - është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi);



	- është në listën e projekteve/ nevojave të parashikuara. Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëngjitet një kopje e vendimit/dokumenteve të tjera.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'lloj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; - përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.

(*) Fushat që kanë shenjë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- *Online* në faqen elektronike: www.dsd.gov.al, si edhe

- Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit, pranë sekretariatit teknik (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit).

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik (MZhUT) dhe listën e projekteve të aplikuar. Projektet e aplikuar duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

C. KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si pjesë e sekretariatit teknik, ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial të paraqitura nga aplikantët, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatitë raportin e vlerësimit financiar të tyre e rekomandimet përkatëse.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshtimit të projektit që orientojnë mbi rrishtin e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit, që vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë, sipas komponentëve, si më poshtë vijon:

a) prek qendër-qarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomive vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri 5 pikë.

b) ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.



c) rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

ç) projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimin e korridoreve të gjelbër ndërqytetas, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

4. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Këto kritere përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qëndërqarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 16 lekë